

# POETI MUJO BUÇPAPAJ PREZANTOHET NË AMERIKË

NGA GJEKË MARINAJ

Richardson, më 21 Dhjetor, 2007. Të dielën pasdite në sallën "Prelude" të "Renaissance Hotel" në Richardson të Teksasit, u bë promovimi i librit "Fitorja e Padukshme" të poetit shqiptar Mujo Buçpapaj. Takimi u organizua nga shtëpia botuese Marinaj Publishing, Universiteti i Teksasit në Dallas dhe ALTA (American literary translations organization).

Duke marrë shkas nga mundësitë teknologjike, personeli i hotelit i kishte kushtuar një vëmendje të veçantë mënyrës së paraqitjes së këtij eventi të rëndësishëm. Në muret e sallës së madhe përkrah poezisë plastike të kopertinës së librit dhe portretit të autorit u shfaqën edhe disa pjesë filmike me anë të një video-projektori ku të pranishmit u informuan rreth jetës dhe veprimtarisë letrare të autorit.

Në sallën e sistemuar në stil teatral, dominonte prezenca e të dy flamujve respektiv, atij shqiptar dhe atij amerikan, si në formën tradicionale ashtu edhe në format kreative. Katër balona plastike të kuqe dhe një të zezë në njërin anë, dhe dy të kuqe, dy blu dhe një të bardhë në anën tjetër të tavolinës jepnin efektet e tyre patriotike dhe shfaqnin atmosferën miqësore që ekziston midis Shqipërisë dhe Amerikës.

Përpjekjet e organizuesve për të ngjallur një ndjenjë sa më poetike dhe humaniste me regjinë e tyre, tërhoqën menjëherë vëmendjen e të pranishmeve. Ngaqë pjesëmarrja në promovim nuk ishte e hapur për publikun dhe se shumica e të ftuarve ishin profesorë letërsie, lingvistike si dhe poetë e shkrimtarë amerikanë, organizimi i përgjithshëm u vlerësua si një insentiv shtesë përkrah vlerave të mëdha poetike së solli për ta "Fitorja e Padukshme".

Dusita Marinaj, e cila adresoi të pranishmit në emër të Marinaj Publishing, tha se "çdo përpjekje për ta bërë sa më festive këtë takim, do të linte për të dëshiruar, sepse ajo nuk mund të jetë e të njëjtit nivel me poezinë e poetit Mujo Buçpapaj. Poezia e tij është freski e re, një dimension i ri, një orientim krejt i veçantë në poezinë e përkthyer në anglisht nga poezia e sotme botërore".

Megjithatë mund të thuhet se promovimi e theu rutinën tradicionale të prezantimit të librave në Amerikë. Të paktën kështu mendoi profesoresha e Kolegjit "Richland", Betty Klee, e cila tha përpara kamerave televizive dhe gazetarëve se "... ne jemi mësuar t'i bëjmë prezantimet e librave duke u mjaftuar me një grup spektatorësh prej më pak se dhjetë vetë, dhe në ambiente krejt të thjeshta. Të bësh një promovim libri me një numër kaq të madh spektatorësh, me një audiencë kaq të zgjedhur intelektuale dhe akademike dhe ta zhvillosh takimin në një nga hotelet më të mira në Amerikë siç është "Renaissance Hotel" i Richardsonit, tua them miqësisht, se është dhe do të mbetet një ëndërr për mua."

Libri, që shumica e njerëzve do të binin dakord se është një


botim luksoz nga paraqitja e jashtme, u vlerësua vërtet jo vetëm si një përkthim i arrirë i përkthyesit Ukë Buçpapaj, por më së shumti si një shtim me shumë vlera i poezisë botërore që gjendet sot në libraritë dhe bibliotekat Amerikane.

Vëmendja dhe vlerësimet e emocionuan Buçpapajn.

"Si ndihesh nga gjithë kjo vëmendje që po tregojnë universitetet amerikane, gazetarët, poetet dhe kritikët e këtushme për ju dhe veprën tuaj më të re?" e pyeti Buçpapaj gazetarja e gazetës "The Dallas Morning News" Margaret Putnam.

Poeti Shqiptar, i veshur me një kostum blu me vija gri, në jakën e majtë të së cilit mbante një flamur të vogël metalik shqiptar, u përgjigj: "Ky është një nga momentet më të ndritshme të jetës time. Ky është një vlerësim domethënës jo vetëm për poezinë time, por edhe për gjithë poezinë dhe letërsinë e re shqipe, e cila u prezantua sot me kaq dashamirësi dhe dinjitet në një treg të madh letrar siç është ai Amerikan. Falënderoj me gjithë zemër për këtë organizim të shkëlqyer shtëpinë botuese "Marinaj Publishing", UTD-në dhe organizatën ALTA për nderin e jashtëzakonshëm që po më bëjnë."

Pas prezantimit të poetit nga organizuesit, disa nga profesorët dhe pjesëmarrësit e tjerë të pranishëm lexuan nga podi-



Autori Mujo Buçpapaj duke dhuruar libra me autografe

umi nga një poezi të versionit anglisht për t'ia lënë poetit Buçpapaj mundësinë për të lexuar të njëjtat poezi në versionin shqip të librit. Profetori i lingvistikës, Esteban R. Egea, njëri nga përfaqësuesit e Universitetit të Teksasit në Dallas, tha për gazetarët se "Poezia e Buçpapajt ka vlera të mëdha si poetike ashtu edhe lingvistike. Tematika e tij përfshinë tema si shpresat e njeriut për një fitore të sa do të vonë, për një frymëzim për jetën, si dhe për aspirata të atilla që tentojnë t'i bëjnë njerëzit më njerëz. Poezia që lexova vërtet më preku me dhembjen e saj për Kosovën dhe njeriun e saj. Buçpapaj është një poet për ta patur zili."


Ndërsa përfaqësuesja e

ALTA-s, Charlotte Karam, shtoi se poezia e Buçpapajt duhet të përkthehet edhe në gjuhë të tjera. Nëse ajo ka forcën e duhur poetike për të ngjallur kësajsoj reagimesh pozitive tek lexuesi amerikan, do të ishte mëkat që e njëjta kënaqësi të mos u jepej, fjala vjen, edhe lexuesve latin, aziatik apo atyre të Lindjes së Mesme..."


Në fund të evenimentit, i cili zgjati rreth 2 orë, Buçpapaj falënderoi edhe një herë me emër, midis të tjerëve, Prof. Edward Garcia, Prof. Valeri Smith, Prof. Tim Eyers, Por. Kyle Yets dhe drejtoreshë e Librarisë Publike të Richardsonit Dr. Gane Ritz, për fjalët e ngrohta rreth poezisë së tij dhe për interesimin e treguar për librat e tij të ardhshëm.




Brtty Klee




Charlie Spears



Edward Garcia



Autori i librit falenderon organizatorët dhe pjesëmarrësit



Gjekë Marinaj



Sharmistna Thonky

## JETONI DHE INVESTONI NË ARIZONA

Shteti me më  
perspektivë për të  
jetuar dhe investuar  
në SHBA

Qyteti Phoenix, qytet  
i mrekullueshëm, me  
kushte ideale për të  
jetuar dhe investuar

Kushtet e mrekul-  
lueshme klimatike  
Çmime shumë të lira

Mos humbni kohën  
por telefononi sa nuk  
është bërë vonë.

VASEL DEDVUKAJ  
Specialized in Real Estate Commercial  
602 478 3130



Vasel Dedvukaj  
Realtor

Fitues i çmimit të parë në  
Real Estate në Arizona

3 vite me radhë fitues i  
Grand Centurion Award

Century 21 Arizona Foothills  
3930 East Chandler Blvd. |  
Phoenix-Ahwatukee, AZ 85048  
vdedvukaj@movephoenix.com